



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 03-02/DPK Nr. Prot. 01-1393/16  
 Dep. 03-02/DPK Br. Prot. 01-1393/16  
 Nr. I faq Data 06.04.2016  
 Broj stranica Datum 06.04.2016  
 Nr. pages 02 Date 06.04.2016



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 18 (paragrafi 4, 8 dhe 12) të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.04.2016 mori:

**V E N D I M**

- I. Ekziston konflikti i interesit në rastin me nr. AKK -03-02-4301/15, për z. Beka Hylenaj - Anëtar i Kuvendit Komunal në Skënderaj dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat.
- II. Agjencia do të kërkoj nga institucioni ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij.
- III. Agjencia do të kërkoj fillimin e Procedurës për Kundërvajtje nga Gjykata kompetente.
- IV. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Beka Hylenaj, Anëtar i Kuvendit Komunal në Skënderaj dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.N.Sh "Bia", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (AKK-DPK-01-4563/16), pas pranimit të kësaj shkresa, kemi njoftuar zyrtarin e lartë për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtarit të lartë z. Hylenaj, i është bërë e ditur se gjatë ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë nuk mund të ushtroj funksion menaxhues në biznes privat, kjo për faktin se Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Nr.04/L-051) e ndalon një gjë të tillë. Neni 15 (paragrafi 1) i këtij ligji shprehimisht thotë:

*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private”.*

Agjencia Kundër Korrupsionit i ka dërguar shkresë paralajmëruese zyrtarit të lartë (AKK-01-456/16), me të cilën i është kërkuar që brenda afati ligjor të ndërmarrë veprimet e nevojshme për tu larguar nga funksioni menxherial në biznesin e tij privat në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Përkundër afatit ligjor të dhënë nga Agjencia z. Hylenaj nuk ka shmang gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në bazë të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, zyrtari i lartë ka për detyrë të parandaloj dhe të zgjidhë vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tij të interesit (neni 8 paragrafi 1, Ligji Nr.04/L-051).

II. Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e funksionit Publik (Nr.04/L-051) Neni 20, pika 1, çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuara në paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3.

Sipas nenit 20 pika 2, “Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtari i lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përveç dënimit gjykata mund ti shqiptoj edhe masën mbrojtëse; ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit”.

III. Sipas Nenit 18 paragrafi 12, të gjitha Vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./ znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Prëteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

